

Ndryshimet në mënyrën se si lëvizni nëpër Dandenong



Rruga e re hapet këtë shtator

Nënkalimi rrugor i ri në Dandenong, i cili lidh rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond hapet këtë shtator, dy vjet para afatit të parashikuar.

Kur nënkalimi rrugor i ri të hapet, do të jeni në gjendje të vozisni drejtpërdrejt nga rrugët Cheltenham dhe Hammond në perëndim, nën linjën hekurudhore deri në Princes Highway-Lonsdale Street në lindje.

Rruga e re do të ridrejtojë makinat dhe kamionët larg qendrës së gjallë të Dandenong-ut, duke krijuar një rrjet rrugor më të besueshëm.

Për vendasit, punëtorët dhe vizitorët kjo do të thotë udhëtime më të shpejta dhe më të sigurta dhe më pak mbingarkesë, duke mbështetur rritjen e ardhshme të Dandenong-ut.

Po vazhdojmë ndërtimin e nënkalimit, hidroizolimim dhe mureve dhe dyshemesë dhe instalimin e një sistemi të ri kullimi, i cili pompon ujin në një bazen akumulues, ku filtrohet në mënyrë të natyrshme para se të derdhet në përroin Dandenong.

Vitin e kaluar kemi mbyllur rrugën Webster te kalimi në nivel dhe kemi hapur një shteg të ri për ecje dhe çiklizëm përgjatë rrugës Webster në Rezervatin Woodcock, i cili lidhet me shtegun Dandenong Creek, duke lidhur vendasit me qendrën e Dandenongut.

Në pranverë do të instalohen vepra të reja arti përgjatë shtegut të ecjes dhe çiklizmit nën urën hekurudhore.

Përfitimet e projektit



Barrierat janë zhdukur në rrugën Webster, duke zvogëluar për më shumë se një orë kohën e udhëtimit në pikun e mëngjesit (nga ora 07:00 deri në orën 09:00)



Përmirëson sigurinë, zvogëlon mbingarkesën dhe krijon një rrjet rrugor më të besueshëm



Devijon trafikun larg qendrës së Dandenong-ut



Mban kamionët larg rrugës Webster



Përgatit zonën për zhvillim në të ardhmen



Pamja e nënkalimit të ri, nga lindja ndaj rrugës Princes Highway-Lonsdale

Duke udhëtuar nëpër Dandenong

Kur nënkalimi rrugor i ri të hapet në shtator, do të ketë mënyra të reja për të lëvizur dhe ndryshime në mënyrën se si udhëtoni nëpër Dandenong.

Nënkalimi i ri rrugor Cheltenham

Kur nënkalimi rrugor i ri të hapet, ai do të bëhet një zgjatim i rrugës Cheltenham.

Do të udhëtoni nga rrugët Cheltenham dhe Hammond në perëndim, nën linjën hekurudhore, deri në rrugën Princes Highway-Lonsdale në lindje.

Në kryqëzimin e ri në rrugën Princes Highway-Lonsdale, shoferët do të jenë në mundësi të kthehen majtas ose djathtas pa kufizime për t'u kthyer në orët e pikut

Nënkalimi i ri krijon një lidhje të drejtpërdrejtë lindje-perëndim për automjetet e të gjitha madhësive.

Me një hapësirë prej 5,4 metrash nën urën hekurudhore, nënkalimi i ri do të lehtësojë qarkullimin e kamionëve dhe automjeteve të rënda nga rrugët lokale dhe nga qendra e Dandenong-ut.

Nënkalimi rrugor i ri do të ketë dy korsi në secilin drejtim, duke e bërë udhëtimin më të besueshëm për të gjithë.

Rruga Princes Highway-Lonsdale

Do të instalojmë një kryqëzim të ri të sinjalizuar dhe vendkalime për këmbësorët në rrugën Princes Highway-Lonsdale dhe në kryqëzimin e rrugës Cheltenham për të siguruar lidhje më të sigurt dhe më të drejtpërdrejta për të gjithë ata që kalojnë rrugët.

Rruga Webster në lindje do të riemërohet Dow Court

Me rrugën Webster të mbyllur në linjën hekurudhore dhe linjat Cranbourne dhe Pakenham pa barriera, seksioni i rrugës në lindje të linjës hekurudhore do të riemërohet Dow Court për nder të Pat Dow.

Dow Court do të ketë vende parkimi në anë të rrugës dhe hapësirë për shoferët që të kthehen. Shoferët do të jenë në mundësi të kthehen majtas dhe djathtas nga Dow Court Rruga Princes Highway-Lonsdale, me semaforë të instaluar nga fundi i shtatorit. Në Dow Court do të lejohet vetëm hyrja nga e majta



Një pjesë e rrugës Cheltenham do të rrimërohet Merle Parade

Kur të hapet nënkalimi i ri në shtator, në pjesën e rrugës Cheltenham Road mes rrugëve Foster dhe Hammond Road do të lejohet dalja vetëm majtas drejt rrugës së re. Ky seksion i rrugës Cheltenham do të rrimërohet Merle Parade për nder të Merle Mitchell AM.

Për të hyrë në rrugën Foster, shoferët që udhetojnë drejt lindjes përmes Dandenong-ut do të përdorin nënkalimin e ri, do të kthehen në rrugën Princes Highway-Lonsdale dhe do të kthehen majtas në rrugën Foster.

Në rrugën Merle Parade dhe rrugën Foster midis rrugëve Thomas dhe Princes Highway-Lonsdale Street do të lejohet një shpejtësi maksimale prej 40 km/orë.

Rruga Thomas

Skaji jugor i rrugës Thomas do të rihapet për automjetet pas hapjes së rrugës së re, duke u bërë me një drejtim dhe duke u lidhur me rrugën Lonsdale Street-Service Road. Ky seksion i ri i rrugës Thomas do të ketë tetë vende parkimi në anë të rrugës dhe tetë vende parkimi të futura në trotuar.

Do të ketë gjithashtu hapësirë për të mundësuar që shoferët të kthehen para seksionit njëdrejtimësh të rrugës Thomas.

Kufiri i shpejtësisë për rrugën Thomas do të jetë 40 km/orë.

Për të hyrë në rrugën Lonsdale-Service Road, shoferët që udhetojnë drejt jugut në rrugën Princes Highway-Lonsdale mund të kthehen mbrapa në kryqëzimin e sinjalizuar të nënkalimit rrugor të ri.

Në nënkalimin rrugor të ri dhe rrugën Princes Highway-Lonsdale midis rrugëve Foster dhe Webster do të lejohet një shpejtësi maksimale prej 60 km/orë.



Merle Mitchell AM

Emrat e reja të rrugëve të Dandenong-ut

Së bashku, emrat e reja nderojnë dy gra të jashtëzakonshme, përkushtimi i të cilave i dha formë qytetit të madh të Dandenong-ut.

Merle Mitchell AM

Merle Mitchell AM ishte një mbrojtëse e drejtësisë sociale, e njohur në nivel kombëtar, dhe ka shërbyer si drejtore ekzekutive e Këshillit Australian të Shërbimit Social, duke mbështetur Këshillin për të Moshuarit dhe duke themeluar Byronë e Ndihmës dhe Këshillimit Komunitar në Springvale (SCAAB). Ajo është dekoruar me titullin Anëtare e Urdhrit të Australisë (AM) në vitin 1991.

Për më shumë se 20 vjet, përmes punës së saj me SCAAB, Merle ishte pjesëmarrëse aktive e përpjekjeve humanitare të Springvale për të siguruar strehim dhe shërbime

integrimi për mbi 30.000 migrantë dhe refugjatë nga e gjithë bota.

Pat Dow

Pat Dow ishte një mbështetëse e patundur e Dandenong-ut, duke kontribuar si vullnetare për më shumë se 30 vjet në organizata të tilla si Shoqata Ndihmëse e Spitalit të Dandenong-ut, Kryqi i Kuq dhe 'Meals on Wheels'.

Ajo ishte gjithashtu një përkrahëse e madhe e Festivalit të Muzikës dhe Artit për Rininë në Dandenong dhe ka ndihmuar në udhëheqjen e një fushate dhjetëvjeçare për mbledhjen e fondeve për ndërtimin e Sallës së 12-të të Skautëve në Dandenong.



Pat Dow



Nënkalmi rrugor i ri, pamja nga perëndimi drejt rrugëve Cheltenham dhe Hammond. Ilustrim artistik – mund të ndryshojë.

Ndryshimet në mënyrën se si udhëtoni

Në muajt e ardhshëm, do të ndajmë me ju më shumë informacion lidhur me datat kryesore dhe mënyrën se si do të udhëtoni nëpër Dandenong kur të hapet rruga e re.

Ndërsa po vazhdojmë të ndërtojmë nënkalmimin rrugor të ri, do të ketë ndryshime në mënyrën se si udhëtoni nëpër Dandenong.



Për më shumë informacion, skanoni kodin QR ose vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-travel-changes

Afati kohor i projektit



2018
Projekti u njoftua



2022 deri në fund të vitit 2023
Hetimet në terren, sondazhet e trafikut dhe punimet e planifikimit



Nëntor 2023
– Dizajnet konceptuale janë lëshuar
– Konsultimi me komunitetin
– Hetimet në terren vazhdojnë



Fundi i vitit 2024
– Dizajnet përfundimtare janë lëshuar
– Punimet e para



2025
– Fillon ndërtimi
– Hapet shtegu i ecjes dhe çiklizmit nën linjën hekurudhore
– Barrierat hiqen përgjithmonë
– Rruga Webster mbyllet të kalimi në nivel




2026
– Ndërtimi
– Hapet nënkalmi rrugor i ri
– Sistemi i hapësirave të jashtme



2027
Projekti përfundon

*Afatet kohore mund të ndryshojnë.



Punimet janë në vazhdim, dyqanet dhe bizneset janë të hapura

Tregtarët në rrugët Thomas, Lonsdale dhe Webster janë të hapur për biznes.

Ju falënderojmë që blini lokalisht gjatë ndërtimit.



levelcrossings.vic.gov.au
levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au

1800 105 105
(telefononi në çdo kohë)

in



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.

Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni relayservice.gov.au

